

# Pyetje te shpeshta per aplikimin online per llogari rrjedhese ne Banken Raiffeisen

1. Si mund te aplikoj online per hapje te llogarise?

- ❖ Ju mund te aplikoni online per hapje te llogarise duke u regjistruar ne platformen per aplikime online permes ketij linku [apliko.raiffeisen-kosovo.com](http://apliko.raiffeisen-kosovo.com). Aplikimi per hapje te llogarise behet ne 5 hapa te thjeshte.

2. Per cfare llogarie mund te aplikoj online?

- ❖ Ju mund te aplikoni per llogari rrjedhese dhe Pako te llogarive ( Bazike, Standard & Premium)

3. Cilet kliente mund te aplikojne online per llogari?

- ❖ Klientet te cilet mund te aplikojne online per llogari jane klientet individual perfitues te pakos financiare nga Qeveria dhe klientet individual resident te Kosoves.

4. Cfare informata duhet te plotesoj gjate aplikimit per hapje te llogarise?

- ❖ Te dhenat te cilat kerkohet ti plotesoni jane: Te dhenat perosonale, adresa e banimit , bashkangjitja e dokumenteve si Leternjoftimi ose Pasaporta dhe nje fature komunale jo me te vjeter se 3muaj dhe nje video regjistrim I shkurter per tu identifikuar.

Pas aplikimit ju do te kontaktoheni nga banka per hapa te me tutjeshem

5. Cili eshte dallimi ne mes te klienteve perfitues te pakos financiare dhe klienteve te tjere?

- ❖ **Klientet perfitues te pakos financiare** - Pas aplikimit dhe kontaktimit nga banka me video telefonate, llogaria do ta jete aktive dhe mund te procesohet shuma e pranuar nga Qeveria. Klientet pas perfundimit te pandemise do te ftohen ne dege per nje afat te caktuar per te nenshkruar kontraten e rregullt dhe ne rast se nuk viztojne degen para afatit te percaktuar kohor llogaria do te mbyllet.

Nuk kane te drejte per asnje produkt ose sherbim tjeter deri ne rikthimin e klienteve te rregullt, permes identifikimit ne dege.

- ❖ **Klientet jo perfitues te pakos financiare** - Llogaria do te aktivizohet pas vizites se klientit ne dege.

Nese klienti nuk viziton degen brenda afatit 30 ditore per te aktivizuar llogarine - llogaria do te mbyllet.

Klienti duhet te vizitoj degen me dokumentin identifikues (passaport leternjoftim) dhe faturen jo me te vjeter se 2 muaj.

5. Nese klientet perfitues te pakos financiare deshirojne te pranojne mjete te tjera ne llogari apo te shfrytzojne llogarine per destinim tjeter, si duhet te veprojne?

- ❖ Ne rast se deshironi qe pas pranimit te mjeteve nga pako financiare te shfrytzojehet llogaria per sherbime te tjera ju duhet te vizitoni degen me dokumentin identifikues (passaport leternjoftim) dhe faturen jo me te vjeter se 2 muaj, per tu rikthyer ne kliente te rregullt.

6. Si mund ta porosis Debit Kartelen?

- ❖ Kartela per klientet perfitues te pakos financiare nga Qeveria do te porositet nga ana e bankes do te jete e gatshme qe klientet ta terheqin gjate vizites ne dege. Kartela do te shfrytzojehet vetem per terheqje apo pagesat ne shumen e pranuar nga Qeveria me POS.

Nese deshironi qe llogaria te jete aktive per te gjitha sherbimet dhe produktet e bankes atehere gjate vizites ne dege per terheqjen e debit karteles ju mund te perfundoni edhe procesin e verifikimit me nje Fature & ID ne menyre qe te riktheheni ne kliente te rregullt.

Klientet jo perfitues te pakos financiare nuk kane te drejte te terheqin debit kartelen pa perfunduar nenshkrimin e kontrates dhe sjelljen e dokumenteve ne dege.